



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 195 prot.

Tiranë, më 19.01.2026

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

**MINISTRISË SË DREJTËSISË**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka marrë në shqyrtim shkresën tuaj me nr.6521/2 Prot., datë 24.12.2025, administruar me tonën me nr.3311 Prot., datë 29.12.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për propozimin e projektligjit”, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 37, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” (në vijim “Projektvendim”) si dhe dokumentacionin shoqërues të tij.

Nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve konstatojmë se ky projektligj, ka si qëllim të forcojë garancitë procedurale për të miturit të pandehur dhe nën hetim në procesin penal, si dhe harmonizimin e legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Nisur nga natyra delikate e të dhënave personale si dhe kategoria e subjekteve të përfshira në këtë projektligj, respektimi i standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale, përbën një detyrim thelbësor.

Në këtë kuadër, sa i përket përmbajtjes së projektligjit, Zyra e Komisionerit vlerëson se në disa nene është e nevojshme që paragrafët në të cilat përcaktohen dispozita që lidhen me përpunimin e të dhënave personale të riformulohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në vijim, propozojmë të mbahen në konsideratë sugjerimet si më poshtë vijon.

**Shkronja c), e pikës 3/1 të nenit 2 të projektligjit**, sugjerojmë që të riformulohet me këtë përmbajtje “të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale”.

*Në pikën 3/4, të nenit 2 të projektligjit* përcaktohen personat të cilëve mund t'u vihet në dispozicion informacioni që lidhet me një të mitur pas marrjes në dijeni për statusin si i dyshuar ose i pandehur, përkatësisht “*personi i besuar*” dhe “*prindi i të miturit*”. Ndërkohë, ***në pikën 5 të nenit 19/1*** parashikohet edhe “*përfaqësuesi ligjor*”. Në këtë kontekst, vlerësohet e nevojshme unifikimi dhe përcaktimi i saktë i rrethit të personave që legjitimohen të kenë akses në këtë informacion, duke marrë në konsideratë se në legjislacionin specifik por edhe në atë për mbrojtjen e të dhënave personale parashikohet edhe “*kujdestari ligjor*”, i cili ushtron të drejta dhe detyrime përfaqësuese në interes të të miturit. Ky saktësim sjellë qartësi dhe është i nevojshëm për garantimin e përputhshmërisë normative dhe zbatimit të unifikuar të dispozitave përkatëse.

*Në pikën 1, të nenit 20/1, të projektligjit*, sugjerojmë që pas togfjalëshit “*...nëpërmjet mbrojtësit të tij...*” të shtohet togfjalëshi “*dhe në respektim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale...*”.

*Neni 135/1, të projektligjit*, sugjerojmë të riformulohet me këtë përmbajtje:

#### ***Neni 135/1***

##### ***Mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave personale që lidhen me të miturin***

- 1. Të dhënat personale dhe çdo informacion që lidhet me të miturin në kuadër të procedimeve penale përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe proporcionale, vetëm për qëllimet e parashikuara nga ky Kod dhe në respektim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.*
- 2. Aksesi në të dhënat personale që lidhet me të miturin kufizohet vetëm për autoritetet kompetente dhe personat e autorizuar, në masën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre ligjore në procedimin penal, duke garantuar konfidencialitetin dhe sigurinë e përpunimit të tyre.*
- 3. Të dhënat personale dhe informacioni që lidhet me të miturin ruhen vetëm për periudhën e nevojshme për realizimin e qëllimeve të procedimit penal ose për përmbushjen e detyrimeve ligjore të autoriteteve kompetente. Pas përfundimit të kësaj periudhe, të dhënat fshihen, anonimizohen ose i nënshtrohen kufizimit të përpunimit ose arkivimit në një regjim të veçantë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
- 4. I mituri, ose personi që ka arritur moshën madhore dhe ka qenë subjekt i procedimit penal si i mitur, gëzon të drejtat e “subjektit të të dhënave” të parashikuara nga ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, për aq sa ushtrimi i këtyre të drejtave nuk cenon qëllimet e procedimit penal dhe respekton kufizimet e parashikuara nga ligji.*
- 5. Ndalohet përhapja ose vënia në dispozicion palëve të treta, të vendimeve, të dhënave të regjistrave penale ose çdo të dhënë tjetër që lidhet me veprat penale të kryera nga i mituri, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga ligji dhe vetëm kur është e*

*domosdoshme, në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me interesin më të lartë të të miturit.*

Sa më sipër, me reflektimin e propozimeve të sipërpërmendura, projektvendimi vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**